

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Policia sqaron ndalimin e hyrje-daljeve dhe parkimit në Kuvend e Presidencë
ADRESA	https://indeksonline.net/policia-sqaron-ndalimin-e-hyrje-daljeve-dhe-parkimit-ne-kuvend-e-presidence/
BURIMI	indeksonline.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 17:14:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 15:07:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	899f6dd918841a31baa78e8b7ee03d08151d19922869f8748f2711860512e4ee
TEKSTI	cdcc737671560ab828d88da81df8490faac71daf38c89eb0b90b03fd7514b028
PAMJA	716426da211f120fb302cb4e259686d16b4bdc4cd7a9eaa448c351b43053b63

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	baf188f13015ea4573a68874872af170adf889b77e5f83d275e8a91b1e3d2a4b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ce7404fea9547f7baed0d25532c9a74ec9d95bb0671ef1d2d9a3084bcef35e09
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmSkaPdmqPqwwLNW5etCHb3hJy6s89F3sGnMGHdqRXeFrz



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/baf188f13015ea4573a68874872af170adf889b77e5f83d275e8a91b1e3d2a4b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

SHPERNDAJE

17:07 / E Martë, 08 Shtator 2026 / FR

Policia sqaron ndalimin e hyrje-daljeve dhe parkimit në Kuvend e Presidencë



Policia e Kosovës ka dalë me sqarim lidhur me hyrje-daljet dhe parkimin e automjeteve në hapësirat e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Presidencës.

Në një njoftim për media, Policia ka bërë të ditur se sqarimi vjen pas disa kërkesave dhe pyetjeve të pranuar nga mediume të ndryshme, me qëllim të informimit të drejtë të mediave dhe opinionit publik.

“Policia e Kosovës (PK), pas pranimit të disa kërkesave/pyetjeve nga mediume të ndryshme dhe me qëllim të informimit të drejtë të mediave dhe opinionit të gjere, përmes kësaj komunikate zyrtare bënë publike informacionet lidhur me hyrje-daljet dhe parkimin e veturave në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Presidencës”, thuhet në njoftim.

Sipas Policisë, Drejtoria e Shërbimeve Teknike të Kuvendit ka kërkuar zyrtarisht që gjatë ditës së sotme, 8 shtator, të mos lejohet hyrja, dalja dhe parkimi i automjeteve në hapësirat e ndërtesës, me përjashtim të veturave zyrtare të Kuvendit dhe Zyrës së Presidentes.

“Zyrtarë kompetent nga Drejtoria e Shërbimeve Teknike të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përmes shkresës zyrtare kanë njoftuar dhe njëherit kërkuar nga Policia e Kosovës, që me datën 08.09.2026, përveç veturave zyrtare të Kuvendit dhe Zyrës së Presidentes së Kosovës, të mos lejohen Hyrje-Daljet në vend parkingjet e ndërtesës të asnjë automjeti”, njofton Policia.

Policia ka sqaruar se ndalesa është bërë për shkak të punimeve për pastrimin e oborrit dhe hapësirave të parkingut.

“Arsyeja e kësaj ndalese për datën 08.09.2026, sipas kërkesës zyrtare ishte pastrimi i oborrit dhe vend parkingjeve me mekanizëm adekuat, në të gjitha hyrjet – daljet dhe parkingjet e objekteve, përderisa ditëve në vijim shkresa parasheh kthimin e procedurave të rregullta të hyrje-daljeve dhe parkimit për personat e autorizuar”, thuhet në komunikatë.

Policia ka theksuar se veprimet e saj bazohen në autorizimet ligjore dhe kushtetuese, përfshirë zbatimin e kërkesave zyrtare të institucioneve të Republikës së Kosovës.

“Policia e Kosovës, është institucion i zbatimit të ligjit dhe të gjitha veprimet e saja i ndërmer konform autorizimeve ligjore dhe kushtetuese, përfshirë edhe në rastin e zbatimit të kërkesave zyrtare të institucioneve të RKS-së”, thotë njoftimi.

Mos i humb

Facebook

Follow

Instagram

TË FUNDIT NGA LAJME



19:14 / E Martë, 08 Shtator
Gjini pas mbledhjes së Kryesisë: Jemi dakorduar të mos marrim pjesë në...



18:59 / E Martë, 08 Shtator
Mladenov falënderon Kosovën për pjesëmarrjen në misionin për Gazën



18:36 / E Martë, 08 Shtator
Nis mbledhja e Kryesisë së Aleancës



18:21 / E Martë, 08 Shtator
Kush e di vendimin e Hagës për Hashim Thaçin, Veselin, Selimin e Jakup Krasniqi...



17:53 / E Martë, 08 Shtator
Shqipëria thëllon bashkëpunimin me SHBA-në në mbrojtje dhe siguri



17:22 / E Martë, 08 Shtator
AKK: Shkollat hyjnë në javën e dytë pa dokumentacionin bazë...

TEL

Redaksia: +383 (0) 48 36 36 39 | Marketing: +383 (0) 49 686 666

EMAIL

info@indeksonline.net

marketing@indeksonline.net



Portali Indeksonline u themelua nga një grup gazetarësh kosovarë në vitin 2010. Përball sfidave të gazetarisë bashkëkohore, të motivuar nga nevoja për lajme të shpejta dhe origjinale, në Kosovë, ndër shqiptarë dhe për shqiptarët – Indeksonline nuk ishte vetëm një kërkesë e kohës. Materialet dhe informacionet mund të kopjohen, të shtypen dhe të përdoren por vetëm pas referimit të qartë të burimit të Portalit Indeksonline, në përputhje me kushtet e përdorimit.!!

© 2010 - 2026 Portali Indeksonline. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.